



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:270125
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637013

KPPP.nr.2092/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “FLAMURI V” Sh.P.K., me seli në Malishevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nuhi Krasniqi avokat me seli të zyrës në Malishevë, kundër debitorit Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.248/23 të datës 20.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Shala me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës, ashtu që Urdhri P.nr.248/23 i datës 20.10.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Isa Shala MBETET NË FUQI në tërësi .

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.248/23 të datës 20.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës Nr.23-SHV01-18-1 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-2 të

datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-3 të datës 04.04.2023, faturës Nr.SHV01-18-4 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-5 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-6 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-7 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-8 të datës 04.04.2023, faturës Nr.23-SHV01-18-9 të datës 04.04.2023, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit shumën e borxhit në vlerë prej 41,358.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % në pajtim me LMD-në nga dita e pranimit të faturave, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaremit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka mohuar shumën e borxhit nga kreditori dhe faturat e ofruara, pasi të njejtat nuk janë të përmbareshme por as të pranuar nga mbikqyrësi i projektit, dhe me arsyetimin se nuk janë lejuar mjete nga kryetari i komunës siç parashihet me ligj. Më tej ka theksuar se faturat nuk janë të përmbareshme për faktin se janë nënshkruar njëanshëm vetëm nga operatori ekonomik, dhe vetëm janë dorëzuar në protokollin e Komunës dhe nuk janë të pranuar nga mbikqyrësi i projektit siç e ka paraparë kontrata e prokurimit publik. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në prapësimi i debitorit ose të hapë seancë këshillmore sipas dispozitave të LPP-së.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se faturat nuk janë kundërshtuar nga debitori, si dhe së bashku me propozim është dorëzuar edhe dokumentacioni mbështetës, kontratat si dhe dokumentet me të cilat konfirmohet kryerja e shërbimeve dhe pranimi pa asnjë vërejtje. Më tej ka shtuar se debitori ka qenë i obliguar të zbatoj Ligjin Nr.08/L për mbështetjen e Punëve Publike, ashtu siç është vepruar në një pjesë të Komunave të Republikës së Kosovës duke u bërë kompensimi i Operatorëve Ekonomik të cilët përkundër inflacionit enorm kanë kryer punët e kontraktuara duke u bazuar në këtë ligj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbaremit i Përmbaremit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbardim dokumentet e besueshme: faturën Nr.23-SHV01-18-1 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-2 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-3 të datës 04.04.2023, faturën Nr.SHV01-18-4 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-5 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-6 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-7 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-8 të datës 04.04.2023, faturën Nr.23-SHV01-18-9 të datës 04.04.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij

aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2092/23, me datë 29.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.